

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

24.01.2025

Ora 13:09

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Kamëz, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Lezhë, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 1, datë 13.01.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare”.

Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 2, datë 14.01.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj, znj. A. Nasto


Parti Politike: S’ka

Të tjerë: Qëndresa Qytetare (z.Dh. Zguro) Bashkia Cërrik (znj.M. Xhelili)

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje për shqyrtim:

Shqyrtimin administrativ i veprimtarisë publike të Bashkisë Kamëz, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

Shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Lezhë, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik, për periudhën 11 janar – 18 janar 2025.

Për shqyrtimin administrativ bazuar të denoncimin me nr.1, të regjistrit të paraqitur nga organizata “Qendresa Qytetare”.

Dhe pika e fundit shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr.2, po të “Qendresa Qytetare”. Fillojmë me radhë Pavlina.

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike, të Bashkisë Kamëz, të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, të Bashkisë Lezhë, në lidhje me veprimtaritë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, të zhvilluara gjatë periudhës 11 dhe 18 janar, rezulton se nga sistemi i ndërfaqes elektronike këto veprimtari janë ndaluar automatikisht në sistem për shkak të deklarimit jashtë afatit të caktuar 5 ditor. Kemi komunikuar, kemi shkëmbyer nëpërmjet postës elektronike, i kemi kërkuar prapësime të gjitha institucioneve. Na kanë sjellë brenda afateve ligjore pretendimet e tyre, nga ku kanë rezultuar, i njëjti objekt, kanë qenë për shkak të mosdijes që do të duhet ta deklaronin në këtë afat një pjesë dhe pjesa tjetër ka të bëjë me veprimtari të cilat i kanë anuluar automatikisht,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

duke zhvilluar këtë veprimtari në një ditë tjetër, brenda afateve ligjore të përcaktuara. Nisur nga sa më sipër dhe duke i gjetur të bazuara pretendimet e tyre, ne vlerësojmë se jemi në kushtet ku duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj Bashkisë Kamëz, ndaj Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, ndaj Bashkisë Lezhë, ndaj Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit, si dhe ndaj Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Gjithmonë për periudhën 11 janar, 18 janar 2025.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord do të vendosim kështu, duke e konsideruar të justifikuar pretendimin e tyre në lidhje me afatin, duke konsideruar që ka filluar nga data 11. Kështu që për këtë periudhë nëse mund të them po bëjmë një lloj amnistie, për të gjithë ato institucione që e kanë raportuar për këtë periudhë, deri në datën 16 janar aktivitetin jashtë afatit, jashtë afatit 5 ditor. Po Bashkia Cërrik?

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të kësaj bashkie, ka rezultuar që eventit është deklaruar në faqen, pra është raportuar në faqen NRI jashtë afateve ligjore dhe për më tepër në momentin që ne e kemi konstatuar këtë ndalim nga sistemi. Kemi shqyrtuar edhe veprimtarinë, që ka të bëjë me një pjesëmarrje të kryetarit të bashkisë, ka qenë i ftuar në një takim me diasporën në Selanik të Greqisë, raporti është raportuar në datën 18, për në datën 18, prandaj dhe sistemi e ka ndaluar automatikisht. Njëpërmjet emailit i kemi kërkuar sqarime Bashkisë Cërrik, nga ku ka sqaruar se njoftimin e kanë marrë me vonesë për këtë ftesë, por nisur edhe me themelin, pra të shqyrtimit të veprimtarisë ka rezultuar që personi përgjegjës ka deklaruar se në veprimtarinë ku kryetari i bashkisë merrte pjesë, nuk ishte një veprimtari zyrtare por ishte një veprimtari dhe një takim elektorale dhe këtë veprimtari elektorale e ka publikuar më pas dhe në faqen zyrtare të bashkisë, të kryetarit të bashkisë, pra si veprimtari elektorale. Nga ato që vetë pala deklaroi,

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

e kemi ftuar për këtë seancë dëgjimore, e kemi edhe prezent bashkinë. Për ne mendojmë se është një veprimtari e cila është veprimtari e ndaluar, pasi kryetari i bashkisë, në referencë të ligjit, nuk do të duhet që të publikonte në faqen zyrtare, të kryetarit të bashkisë veprimtari elektorale, pra nuk është një takim pune, por është një veprimtari elektorale.

Z. I. Celibashi: Pra kemi dy elementë.

Znj. P. Doçaj: Për shkak të afatit dhe për shkak të...

Z. I. Celibashi: Mungesa e respektimit të afatit dhe pasqyrimi i veprimtarisë politike në faqen zyrtare.

Znj. P. Doçaj: Po.

Z. I. Celibashi: Po përfaqësues të Bashkisë Cërrrik?

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrrik: Unë jam Mesida, personi përgjegjës, Sekretare e Përgjithshme në Bashkinë Cërrrik. Po me të drejtë pretendimet e ngritura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve qëndrojnë, por për një mungesë informacioni, ne menduam që në aktivitetin ku kryetari i bashkisë është i ftuar, mendoj që mund t'i publikonim dhe pa i raportuar. Kjo është mungesë nga ana jonë. Për pjesën e një takimi elektorale pastaj është e drejtë.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Keni gjë tjetër për të thënë në lidhje me këtë? Jo.

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Çërrrik: Dhe diçka tjetër, shoh që në faqet zyrtare të facebook-ut të bashkive të tjera janë publikuar dhe takime me diasporën dhe nuk dimë si të bëjmë tani sepse ne kemi raportuar dhe tre takime në fundjavë me diasporën në Itali dhe nuk dimë nëse duhet t'i publikojmë apo jo? Jemi brenda afateve ligjore të raportimit por nuk e dimë nëse duhet t'i publikojmë në faqen e facebook-ut apo jo? Këtë po jua kërkoj si ndihmë se ndoshta është paqartësi nga ana jonë.

Z. I. Celibashi: Tani, nëse aktivitetet, ju në faqen zyrtare të internetit apo të rrjeteve sociale të llogarive zyrtare të bashkisë do të duhet të publikoni vetëm aktivitete që lidhen me bashkinë, çfarë lidhet me bashkinë, me punët e bashkisë. Nuk mund të publikoni aktivitete të karakterit politik ose elektoral. Nëse kryetari i bashkisë është duke zhvilluar një aktivitet, ka shkuar në Greqi, a në Itali si përfaqësues politik, për çështje të diasporës apo të tjera, ky aktivitet nuk ka pse të raportohet sepse nuk është aktivitet në cilësinë e tij si kryetar bashkie. Ai po shkon kryetar bashkie atje apo po shkon si përfaqësues politik? Nuk mund të shkojë si të dyja cilësitë, do të duhet ta ndajë mendjen, po shkon si kryetar bashkie apo po shkon si përfaqësues politik? Nëse shkon si kryetar bashkie nuk do të duhet të merret me fushatë elektorale dhe të përcjelli mesazhe politike dhe nuk e di se ç'punë mund të ketë një kryetar bashkie për të shkuar, në cilësinë e tij si kryetar bashkie për të nxitur votuesit nga jashtë. Si përfaqësues politik ai mund të shkojë, por nuk do të mund të shkojë duke angazhuar punonjësit e bashkisë, nuk mund të shkojë duke angazhuar resurset e tjera të bashkisë. Pra është vetë kryetari i bashkisë që duhet ta ndajë mendjen kur shkon. Kur shkon si kryetar bashkie apo shkon si përfaqësues politik? Nuk mund të qëndrojnë të dyja njëkohësisht. Nëse shkon si përfaqësues politik nuk mund të

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

pasqyrojë veprimtarinë e tij si aktivist politik, si drejtues politik në faqen zyrtare të bashkisë.

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik: Më fal, domethënë nuk është e lejuar nëse një kryetar bashkie mund të bëjë një takim me diasporën?

Z. I. Celibashi: Mund ta bëjë këtë po them, mund ta bëjë, po do të duhet ta ndajë mendjen, po shkon si kryetar bashkie atje apo po shkon si aktivist politik. Po shkon për qëllim të partisë x, që përfaqëson ai apo po shkon si kryetar bashkie. Nëse shkon shkon si kryetar bashkie ka sjellje ndryshe, nëse shkon si aktivist politik, le të shkojë si aktivist politik, por nuk do të duhet të ngatërrojme bashkinë me këtë gjë.


Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik: Jo unë nuk e besoj, po shkon si kryetar bashkie në fakt, por takimet ndoshta është pjesa e ndërgjegjësimit për regjistrimin e diasporës...

Z. I. Celibashi: Po si kryetar bashkie, nëse shkon si kryetar bashkie nuk do të duhet që atje të mbledhi përfaqësues të të një partie, të nxisi vetëm ata të partisë, por do të mbledhë të gjithë ata të diasporës, t'u thotë që shikoni, ju që jeni votues nga jashtë të Bashkisë Cërrik do të duhet të regjistroheni.

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik: Pikërisht për këtë konsistojnë takimet.

Z. I. Celibashi: Nëse e bën këtë është i mirëpritur, por dyshoj për të qenë i sinqertë.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik: Tani nuk e di sesi duhet të veprojmë po gjithsesi...

Z. I. Celibashi: Ja pra sapo ta thashë.

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik: Dakord.

Z. I. Celibashi: Sapo ta thashë.


Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik: Jam shumë dakord po...

Z. I. Celibashi: Në qoftë se ai si kryetar bashkie nuk e ndan dot këtë gjë, më mirë mos ta bëjë, mos të rrezikojë, të rrijë aty ku është në bashki.

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik: Po pikërisht atje shkojnë të gjithë, nuk shkon vetëm ata që respektojnë një subjekt politik të caktuar për shembull shkojnë të gjithë emigrantët. Nuk e kuptoj këtë pjesë që si kryetar bashkie apo nuk e di. Gjithsesi ndihemi në siklet...Që raportojmë në KQZ. Ky është problemi.

Z. I. Celibashi: S'keni pse ndiheni në siklet. Aktiviteti që është duke zhvilluar personi është aktivitet që lidhet me punën e tij si kryetar bashkie dhe kjo është e qartë, se besoj ai e di, në qoftë se nuk e di se kush puna që bën si kryetar bashkie pastaj është rëndë situata fare, por besoj e marr të mirëqenë që ai e di se kush është puna e tij si kryetar bashkie, duhet të bëjë vetëm atë punë si kryetar bashkie. Nuk ka ndalim që të shkojë dhe si përfaqësues politik, por nuk mundet ta bëjë këtë edhe si kryetar bashkie edhe si drejtues politik. Kur të paraqitet atje ku shkon do të duhet ta

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

ketë ndarë mendjen, që unë këtu jam duke ardhur, në këtë aktivitet si kryetar bashkie apo si drejtues politik.

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik:Dakord

Z. I. Celibashi: Se nëse shkon si kryetar bashkie nuk mund të përcjelli mesazhe politike, mund t'ju thotë hajde t'ju regjistroj ju të organizatës time, bëni këtë, bëni atë...

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik:Jo, jo. Dakord.

Z. I. Celibashi: Po në qoftë se atje shkon bën një aktivitet, bën takime me gjithë votuesit nga jashtë që i përkasin asaj bashkie, ky aktivitet duhet të raportohet, nuk mund të adresohen gjatë këtij aktiviteti mesazhe politike dhe elektorale.

Znj. M. Xhelili, përfaqësuese e Bashkisë Cërrik:Dakord, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, do të vendosim për këtë çështje në një nga ditët në vijim, do t'ju njoftojmë për vendimin, në lidhje me çështjen që kishim sot në shqyrtim, për aktivitetin që diskutuam. Po, vazhdojmë me dy çështjet e tjera të "Qëndresës...".

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me denoncimin nr.1 që ka marrë në numrin e regjistrimit, jemi në kushtet kur është kryer hetimi administrativ nga ana jonë. Kemi marrë pretendimet e palëve, nga ku pala denoncuese pretendon se aktiviteti është i zhvilluar në bibliotekën e bashkisë, ndërsa pala e denoncuar pretendon që ky aktivitet nuk është zhvilluar në këtë ambient por është zhvilluar në qendrën kulturore të qytetit.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

Ne propozojmë që të shtyhet hetimi administrativ duke caktuar një monitorues që të monitorojnë të paktën këtë ambient, duke qenë se nga fotot nuk provohet nëse ka qenë biblioteka apo qendra kulturore.

Z. I. Celibashi: Tani dy gjëra duhet të ndajmë në lidhje me këtë denoncim, sa është numri i aktiviteteve dhe se cili prej këtyre aktiviteteve ku është zhvilluar, se akoma nuk e kemi të qartë, është një aktivitet apo janë dy aktivitete të ndryshme? Nëse janë dy aktivitete të ndryshme duhet të ndajmë se ku është zhvilluar secili prej tyre, e dyta dhe e treta secili prej këtyre aktiviteteve, i çfarë natyre ka qenë. Ka qenë aktivitet elektoral apo kanë qenë aktivitete në përputhje me fushën e veprimtarisë së bashkisë. Pra këto tre elementë ngelën për t'u verifikuar, numri i aktiviteteve, natyra e secilit prej aktiviteteve dhe ambientet ku janë zhvilluar këto aktivitete. "Qëndresa" ka ndonjë gjë? Jo. Besoj jemi në rregull.

Z. Dh. Zguro, përfaqësues i Qëndresës Qytetare: Jo jemi në rregull. Gjithashtu do të vendosim disa prova shtesë në institucion për të vërtetuar faktin që është ambient i bibliotekës, të cilat janë pamje filmike nga Agjencia Telegrafike Shqiptare.

Z. I. Celibashi: Dakord, depozitoni dhe ato si dokumente. S'ka problem mjafton t'i depozitoni në sekretarinë e KQZ-së. Pra jemi të qartë në atë se çfarë do të duhet verifikojmë, numrin e aktiviteteve, natyrën e secilit prej aktiviteteve dhe ku është zhvilluar secili prej këtyre aktiviteteve. Nga këto do të kuptojmë nëse kemi shkelje apo nuk kemi shkelje. Në lidhje me denoncimin nr.2?

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me denoncimin nr.2, në datën 21.01.2025 u ftuan palët për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, nga ku u dëgjuan pretendimet e tyre. Nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 24.01.2025*

hetimi administrativ rezultoi se u provua se postimet dhe pëlqimet janë bërë në faqet zyrtare të rrjetit social të institucioneve, subjekt i këtij denoncimi. Më pas janë verifikuar nga ana jonë dhe u konstatua se postimet dhe pëlqimet me karakter politik janë fshirë nga rrjetet sociale të institucioneve menjëherë. Për sa më sipër ne vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj titullarëve të këtyre institucioneve.

Z. I. Celibashi: Po dakord me këtë rekomandim dhe meqenëse audituesit e këtyre institucioneve arsimore u paraqitën në seancën e kaluar të gjithë, pranuan faktin që ripostimi apo pëlqimet mbi postimet e bëra nga ministrinë e atyre që ishin me përmbajtje politike, elektorale nuk kishte në përputhje me përcaktimet e aktit të vendimit nr.9 të Rregullatorit dhe Kodit Zgjedhor dhe meqenëse tashmë këta i kanë fshirë ato postime mendoj që është i arritur qëllimi edukativ dhe informues në lidhje me këtë çështje dhe ndaj nuk do të ishte me dobi që të vendosim ndonjë sanksion administrativ, meqenëse pasoja është rikuperuar. Do të vendosim pushimin administrativ. Dakord, jemi në rregull. Çështje të tjera nuk kemi. Seanca mbyllet. Faleminderit! Ditë të mbarë!

Vendimi nr. 31-36

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

